



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**
MINISTRI

Nr. 3242 / Prot
3

Tiranë, më 13.06.2018

URDHËR

Nr. 457, datë 13.06 2018


**PËR NJË NDRYSHIM TË URDHËRIT Nr. 76/1, DATË 24.01.2018
PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË MENUTË USHQIMORE TË ÇERDHEVE DHE
KOPSHTEVE PËR FËMIJËT 0-6 VJEÇ**

Mbështetur në Nenin 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Nenin 12, të Ligjit 9000 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, si dhe në zbatim të pikës 1, të Nenit 46, të Ligjit Nr. 10138, datë 11/05/2009 “Për Shëndetin Publik”, të ndryshuar, nisur nga nevojat aktuale për të bërë disa përmirësime në menutë aktuale për fëmijët 1-6 vjeç në çerdhe dhe kopshte,

MIRAT O J:

1. Ndryshimin e përmbajtjes së Shtojcës 3, të Pikës 7 “Menu 5-ditore, për fëmijët 1-3 vjeç në çerdhe”, sipas Shtojcës 3 “Menu 5 ditore për fëmijët 1-3 vjeç (Dimër – Verë)”, bashkëlidhur këtij Urdhëri.
2. Ndryshimin e përmbajtjes së Shtojcës 4, të Pikës 8 “Menu 5-ditore, për fëmijët 3-6 vjeç në kopshte”, sipas Shtojcës 4 “Menu 5 ditore për fëmijët 3- 6 vjeç (Dimër – Verë)”, bashkëlidhur këtij Urdhëri.
3. Ndryshimin e pikës 10, me këtë përmbajtje, “Për miratimin e disa ndryshimeve të menuve 5-ditore, të fëmijëve 1-3 vjeç dhe 3-6 vjeç në çerdhe dhe kopshte, të njoftohen strukturat përkatëse të Shëndetit Publik në të gjithë vendin, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Tiranë, Bashkitë në të gjithë vendin, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Inspektorati Qendror dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


MINISTRI
Ogerta Manastirliu